



Prishtinë, 15 shkurt 2019

Kodi i ZRRE: V_1107_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,

Bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 pika 1.1.1, 1.1.2, 1.1.3 dhe 1.1.4, nënparagrafin 1.3, 1.4, 1.5, 1.7, 1.13, 1.14, 1.15 dhe 1.16, paragrafi 7 nënparagrafi 7.1, 7.2, 7.4, 7.5 7.6 dhe paragrafi 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15, Nenin 16, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Nenin 39, Nenin 40 paragrafi 8,9 dhe 11, Nenin 42, Nenin 43, Nenin 47 paragrafi 1 dhe 3, Nenin 48 paragrafin 3, Nenin 57 të Ligjit 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë;
- Nenin 7, Nenin 10, Nenin 11, Nenin 12, Nenin 13, Nenin 14, Nenin 16, 19, Nenin 22, Nenin 21, Nenin 22, Nenin 44, Nenin 45, Nenin 51, Nenin 56, Nenin 57, Nenin 58, Nenin 59 dhe Nenin 60 të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike;
- Nenin 10 paragrafi 1, 2, 3, 4, 5, 7 dhe 9 dhe Nenin 14 të Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë;
- Nenin 6, Nenin 7, Nenin 8, Nenin 9, Nenin 10, Nenin 12, Nenin 13, Nenin 14, Nenin 16, Neni 17, Neni 18 dhe neni 27 të Rregullës Nr. 14/2017 për Certifikimin e Operatorëve të Sistemit të Transmetimit, të aprovuar nga ZRRE-ja, me datë 13.04.2017;
- Nenin 5, Nenin 10, Nenin 11 dhe Nenin 12, të Licencës së Operimit të Sistemit të Transmetimit me Nr. ZRRE/Li_15/17 të datës 13.04.2017 dhënë KOSTT SH.A.;
- Kërkesën/aplikacionin për Certifikim si Operator i Sistemit të Transmetimit, të dorëzuar nga KOSTT SH.A.;
- Vendimin Preliminar V_1033_2018 të datës 24 shtator 2018, të lëshuar nga Bordi i ZRRE-së, për Certifikimin e KOSTT SH.A, si Operator i Sistemit të Transmetimit në territorin e Kosovës; dhe
- Opinionin Nr. 02/2019 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për Certifikimin e KOSTT/OST, të datës 01.02.2018, të nxjerr në pajtim me nenin 3 (1) Rregullores (EC) Nr. 714/2009, dhe Nenin 10 (6) të Direktivës 2009/72,

në seancën e mbajtur me datë 15 shkurt 2019, nxori këtë:

V E N D I M

- I. PËR MIRATIMIN PËRFUNDIMTAR TË CERTIFIKIMIT të KOSTT SH.A., si Operator i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, pas marrjes së Opinionit Nr. 02/2019¹ të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (SKE).**

¹ Opinioni Nr. 02/2019 i datës 01 shkurt 2019 për Certifikimin e KOSTT SH.A., I Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

- II. **VËRTETOHET** se **KOSTT SH.A.** ka përmbushur kriteret e shturjes pronësore dhe pavarësisë në vendimmarrje, nga veprimtaria e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike, në pajtim me ligjet e Kosovës dhe të Komunitetit të Energjisë.
- III. **OBLIGOHET** - **KOSTT SH.A.**, pas miratimit të Vendimit Përfundimtar sipas dispozitivit nën pikën I. të këtij vendimi, por jo më vonë se tre (3) muaj, të caktoj Zyrtarin e Pajtueshmërisë i cili duhet të aprovohet nga ZRRE, si dhe të hartoj Programin e Pajtueshmërisë jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga caktimi i Zyrtarit të Pajtueshmërisë, sipas dispozitave ligjore të Nenit 21 të Direktivës së Energjisë Elektrike Nr. 2009/72² KE dhe Nenit 21 të Rregullës për Certifikimin e OST-së³, dhe të njëjtën ta dorëzon në ZRRE për aprovim.

ARSYETIM

- (1) Më 28 prill të vitit 2017, ZRRE ka pranuar kërkesën/aplikacionin nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregu SH.A. (në tekstin në vijim referuar si KOSTT SH.A.) me anë të të cilit kërkohet Certifikimi si Operator i Sistemit të Transmetimit (në tekstin në vijim referuar si „OST“) në bazë të Nenit 12 të Ligjit 05/L-085 për Energjinë Elektrike, Nenit 7 të Rregullës për Certifikimin e OST, dhe në përputhje me modelin e shturjes së pronësisë siç përcaktohet në Nenin 9 (6) të Direktivës së Energjisë Elektrike 2009/72/KE.
- (2) Kërkesa/Aplikacioni është shqyrtuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (tani e tutje ZRRE) mirëpo, për shkak të mungesës së dëshmive dhe mos-kompletimit të aplikacionit, i është kthyer KOSTT-it, me udhëzime lidhur me dëshmitë e nevojshme që duhet të dorëzohen ashtu që kërkesa s’bashku me aplikacionit të konsiderohet si e kompletuar.
- (3) Si rezultat i takimeve dhe komunikimeve në mes të ZRRE-së, dhe KOSTT si dhe komunikimeve dhe udhëzimeve lidhur me kompletimin e aplikacionit të KOSTT të marra nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (në tekstin e më tej më SKE), më datë 03.05.2018 ZRRE ka pranuar kërkesën/aplikacionin nga KOSTT, me dëshmitë e kërkuara.
- (4) ZRRE me datë 03.07.2018, ka njoftuar KOSTT SH.A., se ka vlerësuar dëshmitë e sjelluara dhe pas vlerësimit të tyre ka identifikuar se mungojnë dëshmitë që kanë të bëjnë me ndryshimet në Statut dhe çështjet pronësore, e të cilat KOSTT është obliguar ti sjellë sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që ZRRE ta konsideroj aplikacionin e kompletuar.
- (5) ZRRE me datë 05.07.2018, ka pranuar dëshmitë e kërkuara nga KOSTT SH.A., ku janë bashkangjitur Anex Statuti i ndërmarrjes s’bashku me informatat e biznesit të azhurnuara, kopjet e certifikatave të fletave poseduese dhe kopjet e planit për çështjet pronësore. Nga ky moment ZRRE e ka konsideruar kërkesën/aplikacionin e kompletuar, andaj edhe afati katër (4) mujor për Certifikimin e OST-së, i paraparë me legjislacion në fuqi, ka filluar të rrjedhë.

² Direktivën Nr. 2009/72, e datës 13 korrik 2009 lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike e Parlamentit Europian dhe Këshillit..

³ Rregulla Nr. 14/2017 e datës 13.04.2017 për Certifikimin e Operatorëve të Sistemit të Transmetimit e nxjerr nga Bordi i ZRRE-së.

- (6) Me datë 24 shtator 2018 Bordi i ZRRE-së, në seancën publike ka nxjerr Vendimin V_1033_2018⁴ me të cilën ka lëshuar Vendimin Preliminar për Certifikimin e KOSTT si Operator i Sistemit të Transmetimit në Territorin e Kosovës.
- (7) Me datë 02.10.2018 ZRRE e ka informuar dhe ka dërguar në Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë Vendimin Preliminar për Certifikimin e KOSTT/OST të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e datës 24.09.2018, për vlerësim dhe në pajtim me dispozitat e aplikueshme në fuqi në Kosovë, për dhënien e Opinionit nga SKE lidhur me Vendimin Preliminar.
- (8) Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (SKE), në pajtim me Nenin 10 të Direktivës 2009/72 dhe Nenit 3 të Rregullores (EC) Nr. 714/2009⁵, i kërkohet të shqyrtoj Vendimin Preliminar të ZRRE-së, dhe të jap Opinionin e tij për përputhjen e tij me Nenin 10 paragrafi 2 dhe Nenin 9 të Direktivës 2009/72/EC.
- (9) Me datë 25 janar 2018, Sekretariati ka njoftuar lidhur me Opinionin Nr. 01/2019⁶ për Vendimin Preliminar nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë siç kërkohet sipas Nenit 3 paragrafi 1 të Rregullores (EC) Nr. 714/2009.
- (10) Me datë 30 janar 2019, ZRRE ka pranuar nga Sekretariati kërkesën për të paraqitur dokumente shtesë të nevojshme për vlerësimin e përputhshmërisë me kërkesat e shturjes.
- (11) ZRRE me datë 01 shkurt 2018 nga SKE ka pranuar Opinionin Nr. 2/2019 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për Certifikimin e KOSTT/OST/.
- (12) ZRRE brenda dy (2) muajve pas pranimit të Opinionit të SKE dhe duke marr në konsideratë atë, miraton Vendimin Përfundimtar për Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

Shturja e KOSTT nga aktiviteti i prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike.

- (13) Procesi i Korporatizimit të KOSTT ka filluar pas miratimit të Rregullores nr. 2002/2 të datës 13 qershor 2002 të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK)⁷, kur edhe është themeluar Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM) e të cilës Agjenci, në atë kohë, iu është besuar, ndër të tjera, edhe menaxhimi i Ndërmarrjeve Publike të Kosovës, në të cilën është përfshirë edhe KEK-u. Mandati i AKM-së, ishte ndërmarrja „e çdo veprimi që Agjencia e shihte të nevojshme për të ruajtur dhe ngritur vlerën, qëndrueshmërinë dhe qeverisjen e ndërmarrjeve“, ku për të përmbushur këtë mandat AKM nisi procesin madhor inkorporues për të transformuar këto ndërmarrje në korporata moderne, të qëndrueshme financiarisht, me entitete të definuar qartazi, qeverisje korporative, raportim financiar dhe struktura të audituara (Shtojcë e Vendimit).

⁴ Vendimi Preliminar Nr. V_1033_2018 I datës 24 tetor 2018 për Certifikimin e KOSTT SH..A, i lëshuar nga Bordi i ZRRE.

⁵ Rregulloren Nr. 714/2009/EC, e datës 13 korrik 2009 për kushtet për qasje në rrjetin për shërbimet ndërkuftare të energjisë elektrike e Parlamentit Europian dhe Këshillit.

⁶ Opinioni Nr. 01/2019 I datës 24 janar 2019 për Vendimin Preliminar nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë siç kërkohet sipas Nenit 3 paragrafi 1 të Rregullores (EC) Nr. 714/2009 të Parlamentit Europian dhe Këshillit.

⁷ - Rregullorja Nr. 2002/12 (UNMIK/RREG/2002/12 datës 13 qershor 2002.

- (14) Me 29 prill të vitit 2004 Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin nr. 2004/10 mbi Energjinë Elektrike, i cili Ligj është dekretuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP) më 30 qershor 2004, ku Neni 12 i këtij Ligji ka përcaktuar edhe themelimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST).
- (15) Në tetor të vitit 2005, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nënshkroi Traktatin e Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore (TKEEJL) ("Traktati") i cili hyri në fuqi më 1 korrik 2006, duke i bërë të detyrueshme dispozitat e shthurjes të kërkuara në atë kohë me legjislacionin për energji të Komunitetit të Energjisë. Në mënyrë që të zbatohen kërkesat e TKEEJL dhe legjislacionit për energjinë në Kosovë, Bordi i Drejtorëve i AKM-së më datë 16 nëntor 2005 miratoi një vendim për të transformuar KEK-un në dy kompani të ndara: "Korporata Elektroenergetike e Kosovës Sh.A." dhe "Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut Holding Sh.A.". Me këtë veprim ndërmarrja e energjisë elektrike në pronësi publike e që ishte e integruar në mënyrë vertikale, do të shthuret në dy kompani të ndara dhe të pavarura: - njëra që kryen mihjen e linjitet dhe prodhimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energjisë elektrike, dhe - tjetra që kryen funksionet e sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike dhe operimit të tregut (Shtojcë e Vendimit).
- (16) Më 22 dhjetor të vitit 2005, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut⁸ 2001/6 mbi organizatat e biznesit, Kuvendi i Përgjithshëm i Aksionarëve të KOSTT Holding Sh.A. themeloi KOSTT Sh.A. si kompani vartëse, dhe në të njëjtën datë KOSTT Holding Sh.A. bëri transferimin në KOSTT Sh.A. të 100% të pronës reale të domosdoshme për kryerjen e funksioneve të Transmetimit dhe operatorit të tregut të energjisë elektrike në Kosovë.
- (17) Më 23 dhjetor të vitit 2005, KOSTT Sh.A., u regjistrua me numër të biznesit 7032530 në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovës sipas Vendimit të UNMIK-ut, mbi organizatat e biznesit.
- (18) Më 4 tetor të vitit 2006 ZRRE ka lëshuar Licencën për Operimin e Sistemit të Transmetimit, me numër të referencës ZRRE/Li_15/06⁹, KOSTT SH.A. që ishte i themeluar në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara me Ligjin për Energjinë Elektrike të vitit 2004. KOSTT SH.A. ka në funksion edhe Licencën e Operatorit të Tregut (në tekstin në vijim referuar si „OT“) të lëshuar nga ZRRE, dhe tërë aktivitetin e saj e ushtron në përputhje me autorizimet e dhëna me Licencat e OST dhe OT. Gjithashtu KOSTT Sh.A. mban 12.5% të aksioneve të Zyrës së Ankandit të Koordinuar të Evropës Juglindore (SEE CAO), me nr. të regjistrimit 5-0635601/008¹⁰, të datës 04.07.2012, që është bërë në përputhje me nenin 12 të Rregullores Nr. 71/2009 të BE të adoptuar nga Këshilli i Ministrave të Komunitetit të Energjisë me Vendimin Nr. 2011/02 të datës 06.10.2011.
- (19) Dy kompanitë aksionare, KEK Holding SH.A. dhe KOSTT Holding SH.A. u likuiduan më 02.07.2010 dhe më 20.11.2009 respektivisht sipas nenit 39 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike (Ligji Nr. 03/L-087) i plotësuar dhe ndryshuar.

⁸ - Rregullorja Nr. 2001/06 (UNMIK/RREG/2002/12 dt. 8 shkurt 2001).

⁹ Licenca Nr. ZRRE/Li_15/06 për Operatorin e Sistemit të Trasmisionit (KOSTT).

¹⁰ Zyra e Ankandit të Koordinuar të Europës Juglindore (SEE CAO), Podgorica, Montenegro.

- (20) Kërkesa për shturjen e pronësisë buron nga Direktiva 2009/72/KE për Energjinë Elektrike dhe nga Rregullorja 714/2009, të cilat janë të detyrueshme për Kosovën. Dispozitat e Direktivës dhe Rregullores janë transpozuar në Ligjet e Kosovës¹¹.
- (21) KOSTT është 100% në pronësi të Republikës së Kosovës ("Shtetit"), dhe se aktivitetet e transmetimit të realizuara nga KOSTT janë të ndara ligjërisht nga çdo aktivitet i prodhimit, furnizimit apo shpërndarjes. Edhe pse të dy aktivitetet si i transmetimit në njëra anë, dhe aktivitetet prodhuese në anën tjetër, janë në pronësi të shtetit, POR ato janë nën kontrollin e organeve të veçanta publike brenda Shtetit (Qeverisë për aktivitetet prodhuese dhe Kuvendit të Kosovës për OST).

Menaxhimi dhe vendimmarrja

- (22) Me Ligjin për Ndërmarrjet Publike është përcaktuar korniza ligjore për themelimin e Ndërmarrjeve Publike duke përfshirë pronësinë e Ndërmarrjes Publike KOSTT SH.A., dhe qeverisjen e saj në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtare për qeverisjen korporative të Ndërmarrjeve Publike (Neni 1). KOSTT SH.A. është ende Ndërmarrje Publike sipas përkufizimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike e organizuar në formë të Shoqërisë Aksionare, ndërsa Kuvendi i Republikës së Kosovës ka kompetencën e vetme ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit të ndërmarrjes publike KOSTT në Republikën e Kosovës. Të drejtat e aksionarit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit ushtrohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës sipas Nenit 13 paragrafi 2 i Ligjit për Energjinë Elektrike. Aksionari në mbledhjet vjetore të Bordit përfaqësohet nga i autorizuari i Kuvendit të Republikës së Kosovës i caktuar nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës.
- (23) KOSTT udhëhiqet dhe menaxhohet nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT SH.A., i cili përbëhet prej 7 anëtarëve ku njëri prej të cilëve është Kryesuesi i Bordit. Kryesuesi dhe 5 anëtarët e tjerë të Bordit emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ndërsa Kryeshefi Ekzekutiv, si anëtarë i Bordit të drejtorëve të OST, emërohet nga Bordi i Drejtorëve sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me Ligjin për Ndërmarrjet Publike. Veprimtaria ekonomike e OST menaxhohet nga Bordi i Drejtorëve.
- (24) Bordi i Drejtorëve i OST ka autoritet dhe kompetenca për: miratimin e planeve gjithëpërfshirëse afariste strategjike të kompanisë, kontrollin e brendshëm, Auditimin, si dhe procedurat e menaxhimit të riskut, thirrjen e kuvendeve vjetore dhe të jashtëzakonshme të aksionarëve, përgatitjet e agjendës të kuvendit të aksionarëve, miratimin e raportit vjetor të kompanisë, raportit të bilancit vjetor dhe vlerësimeve vjetore të fitimeve dhe humbjeve të cilat dorëzohen tek aksionari për miratim dhe ka kompetenca për vendosjen e të gjitha çështjeve tjera të cilat kanë të bëjnë me kompetencat ekskluzive të Bordit të Drejtorëve të përcaktuara me Statut të OST-së.
- (25) Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve, sipas Statutit, caktohen me njoftimit me shkrim për mbledhjen, dhe mbahen në zyrën e regjistruar të Shoqërisë apo edhe diku tjetër, kurdo që paraqitet nevoja nga ana e udhëheqësve apo të dy apo më shumë Drejtorëve. Njoftimi për mbledhjen mbahen sipas Axhendës e cila u dorëzohet së paku 3 (tre) ditë para datës së mbajtjes

¹¹ -Ligji për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084 dispozita ligjore të nenit 1 par. 2 dhe nenin 39, Ligji për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085 Nenin 1 par. 2, neni 11, 12 dhe 14 dhe Ligji për Energjinë Nr. 05/L-081 Nenin 1 par 2 „Ligji është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2009/72, lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike, Rregulloren nr. 714/2009/EC, për kushtet për qasje në rrjetin për shërbimet ndërkufitare të energjisë elektrike, dhe Direktivën Nr. 2009/28/EC lidhur me promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e Ripërtrishme“

së mbledhjes. Në mbledhje, udhëheqësi i Bordit të Drejtorëve, duke vepruar arsyeshëm dhe në pajtueshmëri me Ligjin dhe me Statutin, duhet të përcaktoj praninë e kuorumit, të drejtën e debatit, si dhe të mbaj procesverbalin dhe të përcaktoj dhe deklaroj rezultatet e votimit.

- (26) Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve janë valide nëse, prezantojnë shumica e drejtorëve, ndërsa vendimet merren me votën pohuese të shumicës së drejtorëve pjesëmarrës në mbledhje. Drejtorët të cilët abstenojnë nga votimi dhe drejtorët të cilët kanë shpalosur konflikt interesash nuk do të përfshihen në numërimin në lidhje me shumicën. Në rast barazimi të votave, udhëheqësi i Bordit të Drejtorëve ka votën vendimtare. Nëse për shkak të boshllëkut, numri i Drejtorëve është më i vogël se numri i vendosur si kuorum, Drejtorët e mbetur (apo Drejtori) mund të veprojnë vetëm për qëllim të thirrjes së mbledhjes së përgjithshme për plotësimin e vendeve të lira.
- (27) Bordi i Drejtorëve për veprimtarinë e KOSTT SH.A., i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës në baza vjetore dhe sa herë një gjë e tillë kërkohet nga Kuvendi. Raporti vjetor dorëzohet më së largu deri më 30 Qershor të vitit aktual për vitin paraprak (Neni 13 par. 5 Ligji nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike).
- (28) Drejtori Menaxhues/Kryeshefi Ekzekutiv sipas Statutit përfaqëson dhe menaxhon me KOSTT SH.A., si dhe ka kompetenca dhe autorizime të tjera të përcaktuara me Statut. Bordi i Drejtorëve ka të drejtë të delegoj kompetenca edhe autorizime të tjera për ushtrimin e veprimtarisë së KOSTT SH.A., duke përjashtuar çështjet të cilat shprehimisht janë të rezervuara për Bordin e Drejtorëve ose për aksionarin sipas Ligjit, Rregulloreve dhe Statutit (Neni 177 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare).
- (29) Drejtori Menaxhues/Kryeshefi Ekzekutiv, sipas Statutit ka për detyrë të këshillojë dhe asistojë Bordin e Drejtorëve, lidhur me përcaktimin e Strategjisë së Shoqërisë si dhe planet e saja strategjike afatgjate; të themelojë dhe rishikoj strukturën organizative të Shoqërisë; alokimin e fuqisë vendim-marrëse të Shoqërisë, si dhe të fuqisë të ndërlidhjes në mes të udhëheqësve dhe të punësuarve në Shoqëri; propozojë Bordit të Drejtorëve kandidatët të përshtatshëm për punësim; dorëzojë Bordit të Drejtorëve drafte të dokumenteve për bilancin vjetor dhe pasqyrat e fitimit dhe humbjeve të Shoqërisë, gjendjen financiare dhe industriale të Shoqërisë, investime apo shpërndarje të fitimit vjetor apo mbulimin e humbjeve; ti ofroj Komisionit të Auditimit të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkohet; ti ofroj Zyrtarit të Auditimit të brendshëm të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkohet nga ky i fundit.
- (30) Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve është trupi më i lartë vendim-marrës i OST. Vendimet e mbledhjes së përgjithshme konsiderohen të detyrueshme për kompaninë, aksionarin dhe trupat tjerë të shoqërisë. Mbledhja e Përgjithshme thirret nga udhëheqësi i Bordit të Drejtorëve, duke vepruar përmes Sekretarit.
- (31) Njoftimi për Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve iu dërgohet secilit aksionar së paku 30 ditë më herët, në adresat e listuara për secilin aksionar në regjistrin e aksionarëve, si dhe secilit anëtarë të Bordit të Drejtorëve, për më tepër njoftimi bëhet edhe përmes publikimit ashtu siç kërkohet me ligj.
- (32) Kuorumi për Mbledhjen e Përgjithshme mund të mbahet vetëm nëse aksionari është prezent personalisht apo përmes të autorizuarve. Sekretari obligohet që të kryej të gjitha aranzhimet e nevojshme që aksionarët të regjistrojnë aksionet e tyre në Mbledhjet e Përgjithshme.

- (33) Si Udhëheqësi i Mbledhjes së Përgjithshme me vendim të aksionarëve mund të caktohet Udhëheqësi i Bordit të Drejtorëve apo personi i zgjedhur nga shumica e pjesës së prezantuar në Mbledhjen e Përgjithshme. Udhëheqësi i Mbledhjes së Përgjithshme, në pajtueshmëri me Ligjin dhe Statutin e shoqërisë, do të konstatoj prezencën e kuorumit, dhe do drejtoj debatin, dhe të mbaj procesverbalin dhe konstatojë e deklaron rezultatet e votimit.
- (34) Vota e dhënë nga i autorizuari do të jetë e vlefshme. Një vendim i vënë në votim në Mbledhjen e Përgjithshme, vendoset nga numërimi publik. Numërimi fillon menjëherë kur udhëheqësi i Mbledhjes së Përgjithshme udhëzon, në atë mënyrë që të mundëson votimet që i përkasin secilit aksioner për apo kundër vendimit që të numërohet në mënyrë të saktë. Në rast se ka votim të barabartë udhëheqësi i Mbledhjes së përgjithshme (nëse ai apo ajo është aksioner) mund të ketë votë vendimtare.
- (35) Në mbledhjet e Përgjithshme mund të miratohen vetëm vendimet në lidhje me çështjet të cilat janë përmbledhur në agjendë, përveç nëse aksionarët të cilët përfaqësojnë të gjitha aksionet e Shoqërisë e të cilët kanë të drejtë të votojnë dhe janë prezent, pajtohen ndryshe. Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë aksionarët e shoqërisë do të ketë të njëjtën fuqi sikurse edhe vendimi që ka kaluar në Mbledhjen e Përgjithshme që është thirrur dhe mbajtur.
- (36) Mbledhja e Përgjithshme ka kompetenca ekskluzive që të: ndryshojnë statutin dhe aktet nënligjore të shoqërisë; vendosë për ndonjë bashkim, konsolidim, ndarje, shpërndarje, likuidim, transformimin deri në atë masë të lejuar me ligj - në bankrotim apo insolvencë (pa aftësi paguese) të shoqërisë; ngrit apo zvogëlon kapitalin e aksioneve të shoqërisë; vendos për lëshimin e aksioneve; lëshimin e borxhit apo sigurimeve të konvertuara në aksione si dhe konsolidimin apo ndarjen e aksioneve të pa paguara dhe sigurimeve konvertuese; emëron (me propozim të komisionit të auditivit); largon apo zëvendëson auditorët e jashtëm të Shoqërisë etj.
- (37) Ligji për Shoqëritë Tregtare¹² Nr. 06/L-016 përmban dispozita të përgjithshme dhe të detajuara për qeverisjen e përgjithshme të Shoqërive Tregtare e cila gjithashtu përfshinë edhe KOSTT SH.A., ndërsa me Statut jepen detyrat dhe përgjegjësit e shoqërisë aksionare në aspektin e themelimit të saj, kurse me Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike¹³ të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Nr. 05/L-006 në mënyrë specifike përcaktohen të drejtat e aksionarëve të cilat ushtrohen nga Shteti/Aksionari, e në rastin e KOSTT SH.A., Aksionari kryesor është Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Interesi i Shtetit lidhur me prodhimin, furnizimin dhe shpërndarjen me energji elektrike

- (38) Furnizimi me energji elektrike në territorin e Kosovës ushtrohet nga një ndërmarrje në pronësi publike e integruar vertikalisht, me bazë në Prishtinë, e cila quhet „Korporata Elektro-energjetike e Kosovës (KEK SH.A.)“, e cila në atë kohë ishte themeluar sipas ligjeve të Jugosllavisë së asaj kohe. Kompania mihte linjit, gjeneronte, transmetonte dhe distribuonte energjinë elektrike nëpërmjet një rrjeti të ndërlidhur. Sistemi Elektroenergjetik i Kosovës ishte i integruar dhe pjesë e sistemit unazor Jugosllav. Tensionet prej 400 kV, 220kV dhe 110kV konsideroheshin si tensione

¹² - Ligji për Shoqëritë Tregtare Nr. 06/L-016 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9/ 24 Maj 2018).

¹³ - Ligji për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë VITI III/Nr. 31/15 qershor 2008); Ligji Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr/ 13/ 30 maj 2012), Ligji Nr. 05/L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike I ndryshuar dhe I plotësuar me ligjin Nr. 04/L-111 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 10 / 07 maj 2015, Prishtinë).

të sistemit të transmetimit para luftës. Ato mbeten kështu edhe sot (Paragrafi 3 i aplikacionit të KOSTT).

- (39) Në qershor të vitit 1999, pas luftës në Kosovë, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) miratoi Rezolutën¹⁴ 1244 (1999) duke themeluar Misionin e Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Me rënien e ish-Jugosllavisë, ish sistemi ligjor pushoi të jetë i zbatueshëm në të gjithë rajonin. Një nga detyrat e UNMIK-ut, në atë kohë ishte për të rivendosur ligjet që rregullojnë çdo aspekt të shtetit. Paralelisht me këtë ishte thelbësore që të gjitha ndërmarrjet publike në kuadër të Kosovës të përfshihen sërish nën dispozitat përkatëse të atyre ligjeve.
- (40) Qeveria e Republikës së Kosovës mbështetur në Nenin 92 pika 4, dhe nenin 93 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës¹⁵ në mbledhjen e mbajtur më 19.09.2008 ka nxjerr Vendimin Nr. 04/36 me të cilën ka Obliguar Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK SH.A.) të vazhdoj me shturje (ristrukturim) të KEK-ut, në përputhje me Strategjinë e Energjisë të Kosovës 2005-2015. Afati përfundimtar për shturje (ristrukturimin) e KEK-ut ka qenë data 31 mars 2009, në përputhje me politikat e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ndërsa në mbledhjen e mbajtur 02.10.2008, ka nxjerr Vendim me të cilën ka vendosur që kurdo që është e përshtatshme, në pajtim me vendimin e Qeverisë për themelimin e Kompanisë për Distribuimin dhe Furnizimin me Energji Elektrike (KKDFE), kompania e tillë do të privatizohet përmes tenderit publik dhe shitja e aksioneve të saj do të bëhet në pajtim me kërkesat e Nenit 9 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike“
- (41) Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 08.05.2013 ka përmbyllur procesin e tenderimit të KKDFE, me të cilën janë shitur 100% të aksioneve në kompaninë private „Kosovo Calik Limak Energy“ SH.A., proces i cili ka pasur për qëllim përmirësimin e qëndrueshmërisë së sistemit të distribucionit, sigurisë së furnizimit si dhe plotësimin e kërkesave për reformave rajonale në energji, të cilat po i zhvillojnë qeveritë kombëtare, në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropian dhe Traktatin e Komunitetit të Energjisë.
- (42) Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, në mbledhjen e mbajtur me datë 02.05.2013 ka nxjerr Vendimin V-526_2013 me të cilën ka aprovuar ndryshimin në kontroll të të Licencuarit për Furnizim Publik me energji elektrike dhënë „KKDFE“, ndërsa në pikën II. të dispozitivit të Vendimit ka përcaktuar se ndryshimi në kontroll nga Qeveria e Republikës së Kosovës kalon në kompaninë „Kosova Calik Limak Energy“, i cili ndryshim në kontroll ka hyr në fuqi me datën e nënshkrimit të marrëveshjes për shitblerje të aksioneve të „KKDFE“ në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe kompanisë „ Kosovo Calik Limak Energy“ SH.A.
- (43) Shteti ka hequr dorë nga 100% e interesave të tij në furnizimin dhe shpërndarjen me energji elektrike në vitin 2013 me shitjen e Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A. (KKDFE) tek një konzorcium i investitorëve privat, të cilët e kanë në pronësi si dhe operojnë me kompaninë dhe filialet e saja sipas licencës së lëshuar nga ZRRE.
- (44) Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e 20-të, me Vendimin Nr. 04/59 të datës 31.07.2018 ka miratuar Programin Legjislativ për vitin 2018, ku në agjendë ka përfshirë edhe ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin

¹⁴ - Rezoluta 1244/1999 i Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) mbi themelimin e Misionit të Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK).

¹⁵ - Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ratifikuar me date 9 prill 2008 dhe hyrja në fuqi me date 15 qershor 2008. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).

04/L-111 dhe sipas procedurave ligjore të Qeverisë dhe të Kuvendit të Republikës së Kosovës do të aprovohet ky Projektligj, dhe do të largohet nga Lista Kompania Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji (KKDFE), pasi që tani më është ndërmarrje private.

- (45) Qeveria e Republikës së Kosovës ruan interesin në prodhimin e energjisë elektrike, dhe ka 100% të pronësisë së Korporatës Energjetike të Kosovës SH.A. ("KEK" SH.A.), të TC "Kosova A" (Licenca Nr. ZRRE/Li_05/17_ "A „) dhe TC "Kosova B" (Licenca Nr. ZRRE/Li_05/17_B) si dhe të Ndërmarrjes Hidroekonomia „Ibër Lepenc“ SH.A për HC "Ujmani" (Licenca Nr. ZRR/17/17).
- (46) Qeveria e Republikës së Kosovës, bazuar në Nenin 5 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, ka kompetenca ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit në ndërmarrjet publike për gjenerim të energjisë elektrike. Qeveria e Republikës së Kosovës ushtron të drejtat e aksionarit shtetëror në "KEK" SH.A., dhe "Ibër Lepencë" SH.A.(ndërmarrje për gjenerimin e energjisë elektrike), ku kompetencat dhe detyrat për zbatimin e vendimeve të Qeverisë i ushtron Ministria e Zhvillimit Ekonomik, e cila për këtë qëllim ka të drejt të veproj në emër të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Shoqëritë Tregtare (Paragrafi 69 i Aplikacionit të KOSTT).
- (47) Me qëllim që KOSTT të certifikohet si OST i pavarur nga veprimtaria e prodhimit, furnizimit me energji elektrike, është kërkuar që të dëshmohet dhe vërtetohet se Operatori i Sistemit të Transmetimit („KOSTT“ SH.A.) dhe gjeneratorët „KEK“ Sh.A dhe „Ibër Lepenc“ Sh.A, kontrollohen - *de jure* dhe *de facto* - nga dy organe të ndara publike brenda Shtetit.
- (48) Me Nenin 11 të Ligjit për Energjinë Elektrike është përcaktuar procesi i shthurjes së KOSTT SH.A., i cili mban në pronësi sistemin e transmetimit dhe i cili duhet të jetë i pavarur nga veprimtaria e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike dhe i cili do të kryhet në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në dispozitat ligjore të këtij ligji.
- (49) Pavarësia e KOSTT SH.A., konsiderohet e siguar sipas këtij ligji, kur plotësohen këto kushte:
- Personi apo personat që ushtrojnë kontroll të drejtpërdrejt apo të tërthortë mbi ndërmarrjen, që kryen funksionet e prodhimit apo të furnizimit, nuk ushtrojnë kontroll apo të drejta mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit apo Sistemin e Transmetimit;
 - Personi apo personat që ushtrojnë kontroll të drejtpërdrejt apo të tërthortë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi Sistemin e Transmetimit nuk ushtrojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë çfarëdo kontrolli apo të drejta mbi ndërmarrjet që kryejnë funksione të prodhimit apo furnizimit;
 - Në rastet kur personi apo personat [që ushtrojnë kontroll mbi OST] është/janë organ/e publik/e, i njëjti nuk mund të ushtrojë kontroll mbi ndërmarrjet që janë aktive në prodhimin dhe /ose furnizimin e energjisë elektrike;
 - Personi ose personat që emërojnë anëtarët e Bordit mbikëqyrës, bordit administrativ ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht ndërmarrjen e Operatorit të Sistemit të Transmetimit nuk u lejohe të drejtpërdrejtë apo tërthorazi të ushtrojnë kontroll ose ndonjë të drejtë mbi ndërmarrjen që kryen aktivitete të gjenerimit ose furnizimit;
 - i njëjti person nuk ka të drejtë të jetë anëtar i Bordit Mbikëqyrës, apo Bordit Administrativ ose organeve tjera që ligjërisht i përfaqësojnë ndërmarrjet që kryejnë funksione të prodhimit

apo furnizimit dhe të atyre të Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose Sistemit të Transmetimit.

- (50) Para korrikut të vitit 2016 „KOSTT“ SH.A, „KEK“ SH.A. dhe „Iber Lepenc“ SH.A. kontrolloheshin nga Qeveria e Republikës së Kosovës të cilën e ka përfaqësuar Ministria e Zhvillimit Ekonomik sipas dispozitave të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të datës 13 qershor 2008, të ndryshuar me Ligjet 04/L-111 të datës 20 prill 2012 dhe 05/L-009 të datës 7 prill 2015, së bashku "Ligjin për NP-të".
- (51) Më 1 gusht të vitit 2016 ka hyr në fuqi Ligji Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike. Sipas këtij Ligji të drejtat e Shtetit si aksionari i vetëm i KOSTT-it si Operator i Sistemit të Transmetimit, janë transferuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik tek Kuvendi i Republikës së Kosovës. Gjithashtu ligji i ri për Energjinë Elektrike përcakton obligimin e KOSTT-it që të raportoj çdo vit për punën e tij në Kuvend dhe i jep Kuvendit kompetencën për emërimin dhe gjithashtu shkarkimin e Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it në rast të dështimit material që të realizoj detyrat e tij.
- (52) Ligji i ri për Energjinë Elektrike largon zbatimin e dispozitave të Ligjit për Ndërmarrjet Publike ndaj KOSTT-it, sidomos ato që kanë të bëjnë me kompetencën për emërimin e Bordit të Drejtorëve, ushtrimin e të drejtave të aksionarëve, kompensimin e Bordit të Drejtorëve dhe raportimin si dhe emërimin e Komitetit të Auditimit.
- (53) Ligji për Ndërmarrjet Publike (Neni 5) zbatohet plotësisht si për „KEK“ SH.A. ashtu edhe për „Iber Lepenc“ (IL), ndërsa për KOSTT zbatohet Ligji për Energjinë Elektrike i cili në Nenin 14 ka përmban dispozitave ligjore lidhur me kompetencat për emërimin e Bordit të Drejtorëve, ushtrimin e të drejtave të aksionarëve, kompensimin e Bordit të Drejtorëve dhe raportimin dhe emërimin e Komitetit të Auditimit, andaj ZRRE ka vlerësuar që dispozitat ligjore të paraqitura me Ligjin e ri për Energjinë Elektrike parashikojnë ndarjen ligjore të kontrollit mbi interesat e Shtetit për transmision nga ato mbi interesat e Shtetit në prodhimin dhe furnizimin me energji elektrike.
- (54) Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës nuk e ndalojnë shprehimisht dhënien ose pranimin e udhëzimeve midis Ministrive përkatëse, ose ndërmjet Ministrive dhe Presidentit të Republikës së Kosovës, ose ndërmjet Ministrive dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës. Megjithatë, Kushtetuta bazohet në parimin e ndarjes së pushteteve (kompetencave) ndërmjet organit ligjvënës-jo ekzekutiv (Kuvendit), organit të zbatimit të ligjit-organit ekzekutiv (Qeverisë) dhe Presidentit të Republikës. Në aplikacionin e saj, KOSTT-i ka argumentuar se transferimi i të drejtave të aksionarit mbi KOSTT-in nga MZHE (Qeveria) tek Kuvendi i Republikës së Kosovës ka siguruar masa të mjaftueshme mbrojtëse për të siguruar që kontrolli mbi KOSTT SH.A., ushtrohet pa ndikim nga organi publik që ushtron kontroll mbi interesat e Shtetit për gjenerim, gjegjësisht nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
- (55) Kuvendi i Republikës së Kosovës sipas Nenit 65 paragrafi 14 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Nenit 6 të Rregullores¹⁶ së Punës së Kuvendit ka mandat ligjor për emërimin e anëtarëve të Bordit të KOSTT sipas Nenit 14 paragrafi 2 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
- (56) Kuvendi i Republikës së Kosovës, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës të nxjerr me datë 29 prill 2010, dhe pas shqyrtimit të dosjeve përmes komisioneve funksionale përgjegjëse për sektorin e energjisë, dhe pas shqyrtimit nga Kryesia e Kuvendit në pajtim me nenit 14 paragrafi 7 të Ligjit për Energjinë Elektrike, në seancë parlamentare me

¹⁶ - Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 29 prill 2010.

shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë, **zgjedh kandidatët e rekomanduar për secilën pozitë përkatëse të Bordit të Drejtorëve të KOSTT.**

- (57) Me Ligjin për Energjinë Elektrike nr. 05/L-085 në Nenit 62 paragrafi 9 të këtij Ligji, ka përcaktuar që „Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, anëtarët aktual të Bordit të Drejtorëve të KOSTT SH.A., përfshirë kryesuesin dhe Komisionin e Auditimit, vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre deri në përfundim të mandateve të tyre të rregullt“.
- (58) Aktualisht anëtarët e Bordit të Drejtorëve përfshirë Kryesuesin e KOSTT, kanë ende mandat ligjor dhe ushtrojnë të drejtat e tyre sipas Nenit 62 paragrafi 9 i Ligjit për Energjinë Elektrike, ku pas përfundimit të mandatit procedura e emërimit do të zhvillohet sipas dispozitave ligjore të Nenit 14 të këtij Ligji.
- (59) Me Ligjin për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085 është përcaktuar se procedura për emërimin e Bordit të Drejtorëve KOSTT-it do të udhëhiqet nga Ministria e Administratës Publike (MAP), e cila përgatit dosjet e aplikuesve dhe i dërgon në Kuvend. Kandidatët për anëtarë të Bordit të Drejtorëve të KOSTT SH.A., do të zgjidhen sipas procedurave (Neni 14 par. 6 i Ligjit), ku brenda 60 ditësh para kalimit të mandatit të anëtarëve të Bordit të drejtorëve të KOSTT SH.A., apo pas shpalljes së vendit të lirë për arsye tjera MAP bën shpallje publike, brenda periudhës jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj. Komisioni Parlamentar përkatës për energji pas pranimit të dosjeve të aplikuesve i dërgon Kuvendit së paku dy (2) kandidatë për një pozitë të lirë, dhe bazuar në Rregulloren e Punës, Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë, zgjedhin njërin nga kandidatët e rekomanduar për secilën pozitë përkatëse të Bordit, në pajtim me paragrafin 7 të këtij Neni.
- (60) Me qëllim të monitorimit të performancës së të gjitha ndërmarrjeve publike (NP), është themeluar një njësi e dedikuar në kuadër të Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Kompetencat dhe funksionet e kësaj njësie janë të përcaktuara me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, dhe e cila pastaj i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës për punën e NP-ve, si kolektivisht ashtu edhe individualisht. Kompetencat e kësaj njësie nuk shtrihen deri në atë masë sa të japin udhëzime ose ushtrojnë kontrolli mbi ndonjë NP, përfshirë edhe mbi KOSTT, andaj ZRRE ka vlerësuar që njësia e NP-ve nuk është organ që ushtron ndonjë kontroll të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi KOSTT ose ndonjë NP tjetër.
- (61) Sipas ligjit për Ndërmarrjet Publike, organet drejtuese të një NP qendrore siç është KOSTT SH.A., të cilat e përfaqësojnë ligjërisht kompaninë, janë Bordi i Drejtorëve dhe Komiteti i Auditimit. Sipas Ligjit të ri të Energjisë Elektrike, anëtarët e Bordit të Drejtorëve të KOSTT dhe Komitetit të Auditimit, siç u theksua më lartë, mund të emërohen vetëm nga Kuvendi i Kosovës, ndërsa anëtarët e Bordeve të Drejtorëve dhe Komiteteve të Auditimit të „KEK“ SH.A dhe „Ibër Lepenc“ emërohen nga Qeveria, me përfaqësim nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik, sipas dispozitave të ligjit të NP-së.
- (62) Sa i përket Nenit 11 paragrafi 3 të Ligji për Energjinë Elektrike ku „*Ndërmarrjet e energjisë që kryejnë funksione të prodhimit apo furnizimit nuk kanë të drejtë që në mënyrë drejtpërdrejtë apo tërthortë të ushtrojnë çfarëdo lloj kontrolli apo të drejta mbi Operatorin e Sistemit Transmetimit si dhe anasjelltas*“, KOSTT ka paraqitur dëshmi për të argumentuar se aktivitetet e OST janë plotësisht të pavarura si në formën ligjore, organizative dhe pronësore nga aktivitetet e prodhimit dhe të furnizimit me energji elektrike.

- (63) ZRRE bazuar në dispozitat e aplikueshme të ligjeve të Kosovës dhe pas vlerësimit të dëshmime në aplikacion, ka vërtetuar se aktivitetet e OST janë plotësisht të pavarura si në formën ligjore, organizative dhe pronësore nga aktivitetet e prodhimit dhe të furnizimit me energji elektrike.

Pronësia e Sistemit të Transmetimit

- (64) KOSTT SH.A. ka paraqitur dëshmi dhe dokumentacion mbështetës si pjesë e aplikacionit të saj dhe ka demonstruar se është në pronësi të vetme nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe se asnjë organizatë tjetër afariste nuk mban aksione, përfshirë edhe ndërmarrjet energjetike.
- (65) KOSTT SH.A., për të demonstruar se është pronare e asetëve të veta sipas Nenit 12 paragrafi 4 e Rregullës¹⁷ për Certifikimit të OST, ka prezantuar dokumentacion ligjor (Shtojca e këtij Vendimi) që dëshmojnë përvetësimin ose transferimin të aplikuesit të asetëve që përbëjnë Sistemin e Transmetimit. Po ashtu ka bashkangjitur edhe dokumentet të cilat dëshmojnë se disa asetet janë shpronësuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në interes të KOSTT SH.A., dhe për nevoja të KOSTT (Ligjit¹⁸ Nr. 03/L-139 mbi Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-205), si dhe dëshmitë të cilat vërtetojnë pronësinë e aplikuesit.
- (66) Me Ligjin për Energjinë Nr. 05/L- 081 Neni 26 që ka të bëjë me stabilimentet e reja dhe ekzistuese për transmetimin e energjisë elektrike, ka vërtetuar të drejtat pronësore ku KOSTT SH.A., i gëzon të drejtat përkatëse të pronësisë, të shfrytëzimit ose të qasjes sipas Ligjit¹⁹ Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore. Po ashtu edhe linjat e transmetimit të energjisë mund të kalojnë përmes, mbi, në ose nën çdo pronë vetëm nëse ndërmarrja përkatëse e energjisë ka një servitut ose të drejtat të pronës përkatëse, ose servituti apo e drejta e shfrytëzimit jepet ose i merret nga ndërmarrja përkatëse e energjisë në pajtim me këtë ligj, dhe aktet tjera nënligjore.
- (67) Neni 25 paragrafi 1 i po të njëjtit ligj në mënyrë eksplicite i ka dhënë të drejt KOSTT SH.A., që prona e cila aktualisht është në shfrytëzim ose posedim të KOSTT SH.A., ka të drejtën e shfrytëzimit, operimit dhe ka në posedim stabilimentet energjetike të vendosura në një pronë për të cilën KOSTT SH.A., nuk e ka siguruar ose nuk i është dhënë formalisht një servitut, të drejtën e shfrytëzimit ose të drejtën pronësore dhe këto stabilimente energjetike janë në posedim ose shfrytëzim të KOSTT SH.A., atëherë KOSTT SH.A., do të ketë të gjitha servitutet, të drejtat e shfrytëzimit dhe të drejtat tjera pronësore në ose ndaj pronës aktuale.
- (68) Nenin 25 paragrafi 2 jep të drejtat që prona në të cilën ndodhen stabilimentet energjetike do të jepen në shfrytëzim me kohëzgjatje prej 99 vjetëve që fillojnë nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ku sipas kësaj KOSTT SH.A., do të ketë të drejtë të posedoj dhe shfrytëzoj pronën përkatëse, për çdo qëllim që nuk është i ndaluar sipas legjislacionit në Kosovë, të largoj çdo posedues të jashtëligjshëm nga prona, të kompensohet për dëmet e shkaktuara nga poseduesi i paligjshëm, në të njëjtën shkallë sikurse pronarët e pronave të paluajtshme në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe ka të drejt të shesë, të transferoj ose disponoj lirisht me të drejtën e shfrytëzimit ose cilindo aspekt të saj.

¹⁷ - Rregulla për certifikimin e operatorëve të sistemit të transmetimit (Rregulla Nr. 14/2017 dt. 13.04.2017, aprovuar nga Bordi i ZRRE).

¹⁸ - Ligji Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës Kosovës / Prishtinë: VITI IV/ Nr. 52/ 08 maj 2009) dhe Ligji Nr. 03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë / VITI V. NR. 91 / 10 dhjetor 2010).

¹⁹ - Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë / VITI V. NR. 91 / 10 dhjetor 2010).

- (69) Neni 27 paragrafi 7 i Ligjit për Energji i jep të drejt KOSTT SH.A., që të drejtat pronësore të krijuara në bazë të këtij neni, si dhe të drejtat pronësore mbi asetet të dhëna gjatë procesit të inkorporimit të një ndërmarrje të energjisë, e cila ka qenë e licencuar në 2006 për operimin e Sistemit të Transmetimit në Kosovë, pas kërkesës së ndërmarrjes, do të regjistrohen në emër të saj në Rexhistrin përkatës të të drejtave të pronës së Paluajtshme nga Zyra përkatëse Kadastrale Komunale, dhe ky regjistrim do të bëhet pavarësisht ekzistimit apo jo të një kontrate ndërmjet ndërmarrjes së energjisë dhe pronarit të regjistruar në Kosovë, nëse ka një pronar të tillë. Gjatë regjistrimit sipas këtij paragrafi, KOSTT SH.A., duhet të përfshij në regjistrin e pronave të paluajtshme një njoftim i cili përshkruan të drejtat dhe kufizimet që kanë të bëjnë me procedurën e shpronësimit dhe kompensimit sipas Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme të pronarëve privat.
- (70) Neni 28 i këtij ligji i ka dhënë KOSTT SH.A., të drejtën për qasje në pronë, ku KOSTT SH.A., ka të drejtë të ndërtoj stabilimente të reja, apo të zgjerojë stabilimentet ekzistuese të transmetimit për të cilat nevojitet servituti, të drejtat e shfrytëzimit ose të drejtat tjera pronësore në tokën publike dhe private, pajisjeve ekzistuese matëse, ose çfarëdo pajisje tjetër, në apo nën tokën publike apo private sipas dispozitave të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.
- (71) KOSTT SH.A., ka dëshmuar përmes listës së aseteve (Shtojcë të Vendimit) pronësinë, të drejtat e shfrytëzimit të tokës publike dhe private, të drejtën e servitutit, posedimit të stabilimenteve të transmetimit përmes certifikatave të pronësisë, vendimeve të Qeverisë së Kosovës për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme në interes publik të KOSTT SH.A., dhe të drejtat e tjera ligjore për pronësinë e aseteve dhe stabilimenteve përkatëse.
- (72) *Lista e pronave të paluajtshme ku përfshihen objektet energjetike në pronësi të KOSTT SH.A., që janë të dokumentuara edhe me certifikata të pronësisë dhe fleta poseduese, janë pjesë e aplikacionit. Këtu përfshihen: NS Decan Njësia kadastrale P-70505085-00218-2 Lluka e Epërme, Decan; NS Drenas Njësia kadastrale P-70315066-914-0 Cikatovë e Vjetër, Gillogvc; NS Ferizaj 1 Njësia Kadastrale P-72217006-00721-0 Bibaj, Ferizaj; NS Ferizaj 2 Njësia Kadastrale P-72217082-1991-0 Sojevë, Ferizaj; NS Gjakova 1 Njësia Kadastrale P-70705028-04388-20, P-70705028-04388-29 dhe P-70705028-04388-2, Jashtë Qytetit Gjakovë; NS Gjakova 2 Njësia kadastrale P-70705070-00121-0 Zadi Sadik Agës Gjakovë; NS Gjilan 1 Njësia kadastrale P-70403013-01931-0 dhe P – 70403013-01937-0 Gjilan, Gjilan; NS Gjilani 5 Njësia Kadastrale P -72403034-04015-3, P-72403034-04015-5 Koretishtë dhe P-70403016-00107-6 Livoc i Epërm Gjilan; NS Istog Njësia Kadastrale P-70806044-00751-4 dhe P-70806044-894-0 Dubravë, Istog; NS Kamenica Njësia kadastrale P – 71107003-02173-0 Berivojcë, Kamenica; NS Klina Njësia Kadastrale Nr. 898, Nr. 897, Nr. 899-2 dhe Nr. 899-1 Klinavc, Klina; NS Lipjan Njësia Kadastrale P-71409044-00847-0 dhe P-71409044-01325-3 Lipjan, Lipjan; NS Palaj P-72614072-00810-4 dhe P-72614072-00812-4 Caravodicë, Obliq; NS Peja 1 Njësia kadastrale P-71611071-04310-7; P-71611071-04310-8, P-71611071-04310-9 dhe P-70611071-04861-2 Pejë, Peja; NS Peja 3 Njësia kadastrale P-70806003-00054-1 Bellopojë, Istog; NS Podujevë Njësia kadastrale Nr.2896-1;2896-2;2896-3;2896-4;2896-5;2896-6;2896-7;2896-8;2896-9;2896-10;2896-11 dhe 2896-12 podujevë, Podujeva; NS Prishtina 1 Njësia kadastrale P-71914059-01559-6, P-71914059-01559-2 dhe P-71914059-01567-2 Prishtë, Prishtina; NS Prishtina 7 Njësia Kadastrale P-71914075-00551-0 Cagllavicë, Prishtinë; NS Prishtina 4 Njësia Kadastrale P-71914075-00553-0 Cagllavicë dhe P-71914050-00930-2 Matican, Prishtina; NS Prishtina 5 Njësia Kadastrale Nr. 00220/18 Prishtinë, prishtina; NS Prizren 1 Njësia kadastrale P- 71813068-05299-2 Prizren, Prizreni; NS Prizreni 2 Njësia Kadastrale P- 70806003-0002-0 Grazhdanik, Prizren; NS Prizreni 3 Njësia Kadastrale P-71813068-06975-0 dh P-71813068-06955-2 Prizren, prinzreni; NS Rahove Njësia Kadastrale P-71510057-*

07511-1 dhe P-71510057-07511-3 Rahovec, Rahovec; NS Skenderaj Njësia Kadastrale P-72015025-01101-0 Klina e Poashtme, Skenderaj; NS Suharekë Njësia kadastrale P-72116046-02785-2 Suharekë, Suhareka; NS Vitija Njësia Kadastrale P-70101002-00085-5 dhe P-70101002-00082-4 Beguncë, Vitija; NS Vushtrri Njësia Kadastrale P – 70202016-02594-7, P – 70202016-02593-7, P – 70202016-4103-2, P – 70202016-4104-2 dhe P – 70202016-4103-4 Vushtrri, Vushtrri, NS Vushtrria 2 Njësia Kadastrale Nr. 4930-0 Vushtrri, Vushtrria; NS Vallaq Njësia Kadastrale Nr. 558, 559, 560, 1093, 1094, 1095, 1098 dhe 1185 ZK Zitkovac (sipas Fletës Poseduese nr. 135 e datës 12.05.1983); NS Kosova A Njësia Kadastrale P-72614037-01028-1, P-72614037-01028-10, P-72614037-01028-11, P-72614037-01028-12, P-72614037-01028-13, P-72614037-01028-14, P-72614037-01028-15, P-72614037-01028-16, P-72614037-01028-2, P-72614037-01028-3, P-72614037-01028-4, P-72614037-01028-5, P-72614037-01028-6, P-72614037-01028-7, P-72614037-01028-8, P-72614037-01028-9, P-72614055-1893-1, P-72614055-1893-10, P-72614055-1893-11, P-72614055-1893-12, P-72614055-1893-13, P-72614055-1893-14, P-72614055-1893-2, P-72614055-1893-3, P-72614055-1893-4, P-72614055-1893-5, P-72614055-1893-6, P-72614055-1893-7, P-72614055-1893-8 dhe P-72614055-1893-9 ZK Krushevc, Obiliq dhe NS Kosova B Njësia kadastrale P-72614055-01889-0, P-72614055-01890-0, P-72614055-1891-2, P-72614055-01892-1, P-72614055-01892-10, P-72614055-01892-11, P-72614055-01892-12, P-72614055-01892-13, P-72614055-01892-2, P-72614055-01892-3, P-72614055-01892-4, P-72614055-01892-5, P-72614055-01892-6, P-72614055-01892-7 P-72614055-01892-8 dhe P-72614055-01892-9 ZK Obiliq, komuna Obiliq.

- (73) KOSTT SH.A si dëshmi të fitimit të të drejtës së shfrytëzimit afatgjatë për pronat tjera ka prezantuar gjithashtu: Vendimin nr. 01 Nr. 16-631- dt. 29.01.2016 për marrjen në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme Komunale ngastrën kadastrale P-72116046-02785-2, vendi quajtur Shirok, Komuna e Suharekës, Aktvendimin Nr. 778/2014 të Komunës së Vushtrrisë, për fitimit të të drejtës së shfrytëzimit afatgjatë (99 vjet), të ngastrave kadastrale 1/1 nga parcela P-70202016-02594-3, P-70202016-02593-7 dhe ngastrën nr. 4103-2, 4104-2, 4103-4 ZK Vushtrri; Vendimin Përfundimtar nr. 04/90 dt. 05.09.2012 për shpronësimin në interes publik të ngastrave kadastrale ZK Konjuh Lipjan dhe Livagjë: Komuna e Graçanicës, të cilat prekin ndërtimin e linjës 110 kV, vendosja e shtyllave dhe stabilimenteve për zgjerim të rrjetit energjetik dhe shpronësimin me vendim për vendosjen e së drejtës së servitutit në dobi të KOSTT; Vendimin përfundimtar Nr. 14/25 të datës 29.04.2015 për shpronësimin në interes publik të pronave me krijimin e të drejtës së servitutit në pronat e paluajtshme të cilat janë prekur nga ndërtimi i linjës Energjetike 400 kV Kosovë-Shqipëri, Segmenti III., 45 km Zona Kadastrale Pastasell, Poluzhë, Dobridol Zatriq, të Komunës së Rahovecit, ZK Gramaqel, Komuna e Decanit, ZK Junik, Komuna e Junikut, ZK Dabiqevc, Meqë, Bec, Kodrali, Novosellë e Epërme, Batush Molliq, dhe Brovin Komuna e Gjakovës; Vendimi Përfundimtar Nr. 05/106 të datës 10.08.2016 për shpronësimin dhe krijimin e servitutit për interes publik për pronat e paluajtshme të pronarëve dhe zotueseve të cilat janë prekur nga ndërtimi i Linjës së dyfishtë 110 kV Nënstacioni Peja 3 dhe Peja 1 dhe rehabilitimi i linjës ekzistuese 110 kV Nënstacioni Peja 2 dhe nënstacioni Decan, ZK Ozrim, Vitomiricë, Treboviq, Pejë, Komuna e Pejës, ZK Bellopojë Veriq, Llukovcë i Thatë, Gjurakovc, Prekallë, Dobrush, Kiashicë, Bujacë, Komuna e Istogut, të gjitha të përshkruara në listat kadastrale të cilat janë shpronësuar në interes publik me vendimin përkatës të Qeverisë së Kosovës.

Detyrat e OST-së

- (74) Në mënyrë që të certifikohet si OST, KOSTT SH.A është dashur të demonstrojë se i kryen të gjitha detyrat e një OST sipas Nenit 12 të Direktivës 2009/72/EC, dhe e cila është transpozuar plotësisht

në ligjin e Kosovës, siç është paraqitur në Shtojcën e parashtresës së KOSTT SH.A., dorëzuar në ZRRE (Shtojca e këtij Vendimi). Kjo do të thotë se, KOSTT SH.A. duhet të demonstrojë se është përgjegjës për sigurimin e aftësisë afatgjate të sistemit, për përmbushjen e kërkesës së arsyeshme nëpërmjet planifikimit të investimeve. Vendimet që lidhen me operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit, duhet të bëhen nga operatori i sistemit të Transmetimit dhe KOSTT SH.A., duhet të ketë burime të mjaftueshme në dispozicion, për të kryer në mënyrë të pavarur detyrat e veta sipas Nenit 12 të Direktivës. Pajtueshmëria me shturjen e pronësisë, për të cilat edhe KOSTT SH.A., është përgjegjës, mes tjerash, për dhënien dhe menaxhimin e qasjes së palëve të treta në baza jo-diskriminuese për përdoruesit e sistemit dhe për mbledhjen e tarifave të qasjes, tarifat e kongjestionit dhe pagesat sipas mekanizmit të kompensimit ndër-OST.

- (75) Sa i përket pavarësisë financiare dhe aftësisë për të bërë investimet e nevojshme në Sistemin e Transmetimit të Kosovës, ZRRE ka vërtetuar se korniza ligjore dhe rregullatore jo vetëm që siguron mjaftueshmërinë e të ardhurave, por ka realizuar me sukses investimet e konsiderueshme kapitale që nga themelimi i saj në vitin 2006. Plani i miratuar i zhvillimit të rrjetit të KOSTT-it 2017-2026 konfirmon se projektet aktuale dhe të planifikuara financohen nga kreditë e buta nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) të cilat garantohen përmes Ligjit për ratifikimin e marrëveshjes së huas të cilat aprovohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me të cilën shteti ka përgjegjësi të përbashkët me KOSTT SH.A., për të shlyer kreditë, e ku KOSTT SH.A., është përfituese e drejtpërdrejt, si dhe nga fondet e vet KOSTT-it. Këto projekte do të përmirësojnë dhe forcojnë performancën e sistemit në përputhje me Kodin e Rrjetit dhe Doracakun e Operimit të ENTSO-E. Ndërsa ZRRE ka vënë në dukje se KOSTT- nuk kishte realizuar kompensimin e plotë të shtesave të kapitalit sipas tarifës shumëvjeçare të vitit 2012 (MYT), dhe që nga atëherë ka vendosur kontrollë rregullatore më strikte për të siguruar realizimin e investimeve të lejuara kapitale në rrjet. ZRRE ka kompetenca të plota statutores për të zbatuar shkeljet e pajtueshmërisë nga KOSTT.
- (76) Detyrat e KOSTT SH.A., janë përcaktuara sipas Nenit 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe në licencën e OST-së, lëshuar nga ZRRE. ZRRE ka vërtetuar se KOSTT SH.A., nuk ka nën-kontraktuar realizimin e ndonjë prej detyrave (të përcaktuara me Neni 16) ndaj një pale të tretë dhe ka burime të mjaftueshme njerëzore, teknike dhe financiare brenda organizatës, për të përmbushur plotësisht përgjegjësitë e saja statutores dhe të licencës si OST. ZRRE ka vërtetuar se KOSTT SH.A., është e aftë të kryejë të gjitha detyrat me burimet brenda organizatës.
- (77) KOSTT SH.A., posedon me kuadrin e plotë të personelit të nevojshëm për të kryer në mënyrë efektive të gjitha obligimet e saj, si nga aspekti i kompanisë së themeluar sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, ashtu edhe nga aspekti i afarizmit të rregulluar. ZRRE, me rastin e kryerjes së rishikimeve të tarifave shumëvjeçare, shqyrton numrin e punëtorëve të secilit biznes të ndarë, dhe i ndanë funksionet qendrore dhe mbështetëse të entitetit të korporatës për secilin biznes të licencuar, për t'u siguruar që biznesi disponon me burime njerëzore adekuate. ZRRE nuk aprovon ose refuzon kostot e stafit në vetë, dhe KOSTT SH.A., është e lirë të punësojë punëmarrës dhe të përcaktojë nivelet e tyre të pagave, Numri i punëtorëve dhe Struktura kualifikuese sipas departamenteve në KOSTT SH.A., (paragrafi 164 i Aplikacionit).
- (78) KOSTT SH.A. disponon të gjitha burimet të tjera teknike, të nevojshme për kryerjen e plotë dhe efektive të detyrave të tij, të tilla si sistemet e teknologjisë së informacionit të përgjithshëm, duke përfshirë serverët dhe internetin, si dhe teknologjinë e kontrollit të sistemit përfshirë blerjen e funksioneve të kontrollit të sistemit. KOSTT SH.A., ka një strukturë të trajnimeve operacionale, duke përfshirë një dhomë simulimi për stafin e operimit të sistemit. Duke përdorur

këto objekte, KOSTT-i zhvillon trajnime për dispeçer plotësisht në përputhje me kërkesat e ENTSO-E. Dispeçeret e OST-së gjithashtu përfitojnë nga trajnimi përmes një program shkëmbimi me qendrat e tjera fqinje për dispeçer. Forma të tjera jo të specializuara të trajnimeve mund të errën në treg në varësi të nevojave të veçanta të vlerësuara (Paragrafi 165 i Aplikacionit të KOSTT SH.A.).

- (79) Struktura organizative e KOSTTSH.A., është e përbërë nga Bordi i Drejtorëve që përbëhet prej 7 anëtarëve dhe Kryesuesit të Bordit, Kryeshëfin Ekzekutiv, të cilët zgjidhen sipas dispozitave ligjore të nenit 14 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Sekretarin e Kompanisë, Komisionin e Auditimit, Zyrtarin Financiar, Drejtorët e OT, OST, Financave dhe Thesarit, Prokurimit,, Menaxhimin e projekteve, Çështjet ligjore dhe Rregullative, të IT-së, dhe Birimet Njerëzore (Organogrami në shtojcë të këtij Vendimi).
- (80) ZRRE ka vërtetuar se KOSTT SH.A., po kryen të gjitha detyrat të dhëna me Nenin 16 dhe licencën. KOSTT ka paraqitur se nuk është në gjendje të kryej alokimin e kapaciteteve të transmetimit të interkoneksionit, për arsye të cilat janë jashtë kontrollit të saj. Gatishmëria e tanishme e KOSTT-it për të kryer këtë detyrë pasi të bëhet zonë kontrollues është demonstruar nga përmbushja e të gjitha testeve teknike të kërkuara nga ENTSO-E, siç tregohet në raportin e fundit të KOSTT të datës 15 prill 2015, siç përcaktohet në Shtojcën e këtij Vendimi. Gjatë dy viteve të fundit, KOSTT-i ka informuar ZRRE-në, për përpjekjet e saj që të zgjidh mosmarrëveshjen me EMS e Serbisë, veprimet e të cilit kanë penguar hyrjen në fuqi të Marrëveshjes për kyçe mes KOSTT-it dhe ENTSO-E.
- (81) ZRRE vë në pah se mosmarrëveshja me EMS mbetet e pazgjidhur, pavarësisht qëndrimit të Këshillit Ministror në favor të saj në Vendimin²⁰ D / 2016/02 / MC-EnC në tetor të vitit 2016, I nxjerrë në bazë të ankesës së KOSTT SH.A., të bërë në gusht 2008. ZRRE e kupton se përpjekjet për zgjidhjen e çështjes po vazhdojnë në fushën politike midis organeve drejtuese të Komunitetit të Energjisë, Bashkimit Evropian, ENTSO-E dhe palëve, përkatësisht qeveritë përkatëse të Serbisë dhe Kosovës. Me qëllim të monitorimit të përpjekjeve të të licencuarit për përmbushjen e kësaj detyrë, ZRRE ka përfshirë një kusht të ri në licencën e OST-së që i është modifikuar KOSTT-it më 13 prill 2017, sipas të cilës KOSTT SH.A., duhet të njoftojë ZRRE-në, në baza tremujore nëse e njëjta ka qenë në gjendje të përmbush atë. ZRRE është e kënaqur që nuk ka ndonjë pengesë teknike, financiare, njerëzore apo ligjore për realizimin e plotë të detyrës së KOSTT-it për alokimin e kapaciteteve të transmetimit të interkoneksionit si OST. Prandaj, është e mendimit se do të ishte e paarsyeshme dhe e papërshtatshme që KOSTT t'i mohohet statusi i certifikimit vetëm për shkak se realizimi i plotë nga KOSTT SH.A., i detyrave të dhëna me Nenin 12 të Ligjit për Energjinë Elektrike, pengohet nga veprimet joligjore të një pale të tretë jashtë territorit të Kosovës.

Fuqia e ZRRE për zbatim të rregulloreve dhe zgjidhjen e kontesteve

²⁰ - Vendimi I Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë (D/2016/02/MC-EnC mbi dështimin e Republikës së Serbisë për të qenë në përputhje me Traktatin e Komunitetit të Energjisë në rastin ECS – 3/8).

(82) Sipas Nenit 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE ka fuqi ligjore të veprojë në zgjidhjen e kontesteve. Vendimet e saj mbi kontestet (operator-konsumator ose operator-operator) janë obligative, në aspektin administrativ palët kanë të drejtë të iniciojnë konflikt administrativ pranë Gjykatës Kompetente për Çështje Administrative në Prishtinë. Në vitin 2012, ZRRE ka vendosur mbi kontestin mes KEK SH.A., dhe KOSTT SH.A., që kishte të bënte me atë nëse Operatori i Sistemit të Transmetimit KOSTT ka pasur të drejtë të faturojë KEK-un, për shfrytëzim të sistemit mbi bazën e sasive aktuale të transmetuara në vend, të sasive të parashikuara, të përdorura me rastin e vendosjes së çmimeve të rregulluara. ZRRE kishte vendosur në favor të KOSTT SH.A., duke potencuar se korniza rregullatore lejon 'bërjen të vërtetë' të vëllimeve të parashikuara atëherë kur aktualet janë bërë të njohura përmes faktorit KREV (Paragrafi 166 i Aplikacionit). Gjithashtu me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin për Energji ZRRE ka autoritet të imponoj gjoba ndëshkimore mbi secilin person fizik apo person juridik për shkeljet e vërtetuara.

GJETJET DHE REKOMANDIMET E SEKRETARIATIT TË KOMUNITETIT TË ENERJISË (SKE)

Opinionin Nr. 2/19 i SKE i nxjerrë në përputhje me Nenin 3 (1) të Rregullores (EC) Nr. 714/2009 dhe Nenin 10 (6) të Direktivës 2009/72/EC, ka bërë vlerësimin e Vendimit Preliminar për Certifikimin e KOSTT, ndërsa gjetjet/rekomandim janë si në vijim:

1. Vlerësimi gjeneral i SKE lidhur me Vendimin Preliminar të ZRRE-së

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në opinionin e saj ka vlerësuar Vendimin Preliminar të Bordit të ZRRE-së, lidhur me certifikimin e KOST-it, ku ka vlerësuar dispozitat e shtyrjes të hartuara për të ndarë kontrollin mbi Operimin e Sistemit të Transmetimit, në njërën anë, dhe aktivitetet e prodhimit dhe furnizimit si aktivitete konkurruese, në anën tjetër, me qëllim që të eliminohet një konflikt i mundshëm i interesit në mes të transmetimit dhe aktivitete të tjera të ushtruara nga ndërmarrjet vertikalisht të integruara. Kjo objektiv plotësohet më së miri përmes zbatimit të modelit të shtyrjes së pronësisë sipas Nenit 9 të Direktivës së Energjisë Elektrike, të cilën Kosova e transpozoi më Ligjin për Energjinë Elektrike të vitit 2016.

Poashtu ka vlerësuar edhe atë që në një ambient tregu që ende mbizotëron në shumë Palë Kontraktuese përfshirë Kosovën, ku aktivitetet energjetike janë kryesisht të kryera nga ndërmarrjet publike dhe/ose të karakterizuara nga pozita dominuese në tregjet përkatëse, ndarja e kontrollit dhe parandalimi i konflikteve të interesit janë të një rëndësie të veçantë, dhe për këto raste, kur shteti si pronar angazhohet në më shumë se një aktivitet të lidhur me energjinë dhe prandaj duhet të konsiderohet një ndërmarrje e integruar vertikalisht brenda kuptimit të Ligjit European për Energjinë, ku Neni 9 (6) i Direktivës së Energjisë Elektrike ka ofruar një variant të shtyrjes së pronësisë, një alternativë e ristrukturimit dhe privatizimit.

Ndryshe nga rastet tjera të shtyrjes së pronësisë sipas Nenit 9 (1) të Direktivës së Energjisë Elektrike, në situatat e përshkruara në Nenin 9 (6) lidhja e kontrollit brenda ndërmarrjes së Integruar vertikalisht nuk është ndërprerë plotësisht. Ushtrimi i vazhdueshëm i pronësisë publike si dhe lidhjet kushtetuese dhe politike i bëjnë këto situata të dallojnë nga rastet e tjera të shtyrjes së pronësisë dhe ndikojnë në vlerësim. Duke u mbështetur në Nenin 9 (6), siç është transpozuar në Nenin 11 paragrafi 4 të Ligjit për Energjinë Elektrike, arritja e plotë e objektivës së Nenit 9 (1) të Direktivës së Energjisë Elektrike duhet të sigurohet nga autoriteti kombëtar rregullativ në mënyrë pro aktive.

2. **SKE gjatë vlerësimit të përputhshmërisë së Vendimit Preliminar me modelin e shthurjes të përcaktuar në Direktivën e Energjisë Elektrike, ka marr për bazë asetet e mëposhtme siç janë:**

- a) Ndërmarrja që do të certifikohet duhet të jetë pronari i aseteve të transmetimit, siç kërkohet nga Neni 9 (1) (a) i Direktivës së Energjisë Elektrike;
- b) Ndërmarrja që do të certifikohet duhet të kryejë funksionet dhe detyrat e një Operatori të Sistemit të Transmetimit ashtu siç kërkohet nga Neni 9 (1) (a) i Direktivës së Energjisë Elektrike; dhe
- c) Kontrolli dhe ushtrimi i të drejtave në ndërmarrjen që do të certifikohet duhet të ndahet nga kontrolli dhe ushtrimi i të drejtave në ndërmarrjet e përfshira në prodhimin ose furnizimin me energji elektrike dhe gaz natyror, siç kërkohet nga Neni 9 (1) - (3), (7) dhe (12) të Direktivës së Energjisë Elektrike.

Për pikën **a) pronësia e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike**, sekretariati, duke ju referuar Nenit 9(1)(a) të Direktivës 2009/72/EC, Neni 26 dhe posaçërisht Neni 27 të Ligjit për Energjinë (Ligji nr. 05/L-081), konkludon se në rastin konkret, korniza ligjore e Kosovës (Palës Kontraktuese) jep bazë ligjore të qartë dhe kuptimplote, andaj mund të konsiderohet se kërkesat e Neni 9(1)(a) të Direktivës 2009/72/EC janë plotësuar.

Sekretariati ka vlerësuar Nenet 26-27 të Ligjit nr. 05/L-081 për Energjinë përcaktojnë të drejtat e KOSTT-it mbi objektet e reja dhe ekzistuese të transmetimit të energjisë elektrike.²¹Neni 27 (4) i Ligjit për Energjinë përcakton që *"Të drejtat pronësore të përcaktuara me këtë Nen, si dhe të drejtat pronësore mbi asetet e dhëna gjatë procesit të inkorporimit të një ndërmarrjeje energjetike që është licencuar në vitin 2006 për të operuar sistemin e shpërndarjes ose transmetimit të energjisë elektrike të Kosovës, duhet, menjëherë pas kërkesës së ndërmarrjes së energjisë, të regjistrohen në emër të ndërmarrjes së tillë të energjisë në Regjistrin përkatës të të drejtave mbi pronën e paluajtshme nga Zyra përkatëse Kadastrale Komunale."* Neni 27 (2) i Ligjit për Energjinë i jep KOSTT-it të drejtën e servitutit 99 vjet për pronën në të cilën ndodhen objektet energjetike. Asetet e Transmetimit janë llogaritur sipas raportit të Bilancit të KOSTT-it.

Për pikë b) Ndërmarrja që aplikon kryen funksionet dhe detyrat e një operatori të sistemit të Transmetimit, sekretariati është pajtuar me të gjeturat e ZRRE-së se KOSTT SH.A., plotëson kriterin lidhur me burimet e domosdoshme fizike, njerëzore, teknike dhe financiare për ushtrimin efektiv të detyrave/përgjegjësi të Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

Për pikën **c) ndarja e kontrollit mes aktivitetit të transmetimit dhe aktiviteve të gjenerimit/furnizimi**, sekretariati është pajtuar me vlerësimin e ZRRE se:

- (1) **KOSTT SH.A., nuk është përfshirë në aktivitetet e gjenerimit apo furnizimit**, ndërsa lidhur me
- (2) **ndarjen dhe pavarësinë e trupave (entiteteve) publike**, Sekretariati fton ZRRE-në si më poshtë:

- **Të monitoroj procesin e emërimit të Bordit të Drejtorëve të KOSTT SH.A., në mënyrë që një person mos të emërohet edhe në bordin e OST dhe në bordin e gjeneratorit siç kërkohet me Nenin 9(1)(d) të Direktivës 2009/72/EC.**

²¹ Neni 26 i Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081 (Gazeta Zyrtare Nr. 24/13 korrik 2016, Prishtinë).

ZRRE do njoftoj dhe kërkoj nga Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik që në kërkesat e konkursit dhe gjatë procesit të selektimit të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të OST (KOSTT SH.A.) të bëhet në përputhje me dispozitat e Nenit 11 (Shturja) të Ligjit për Energjinë Elektrike, posaçërisht paragrafi 2.4 të këtij Neni, I cili përcakton:

“Në rastet kur personi të cilit i referohet në nën-paragrafet 2.1.,2.2. dhe 2.3. të këtij Neni, është organ publik, i njëjti nuk mund të ushtrojë kontroll mbi ndërmarrjet që janë aktive në prodhimin dhe /ose furnizimin e energjisë elektrike”.

ZRRE do monitoroj situatat e tilla dhe në rast të identifikimit eventual të shkeljeve të dispozitave të Nenit 11 të Ligjit për Energjinë Elektrike, të ndërmerr masa që kjo të evitohet.

- ***Të vlerësoj se si dhe kujt KOSTT SH.A., i paguan dividendën, pasi që në të kaluarën Qeveria e Kosovës ka qenë aksionare e KOSTT SH.A., ndërsa tani Kuvendi i Kosovës është aksionare e KOSTT:***

Sipas Neneve 150 dhe 151 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare Nr. 06/L-016²² dividendat kërkohej nga aksionarët dhe deklarohet nga Bordi i Drejtorëve të ndërmarrjes. Te Ndërmarrjet Publike entiteti që ushtron të drejtat e aksionarit mund të kërkoj nga Bordi i Drejtorëve që ta deklarojnë dividendën. Aktualisht Qeveria e Kosovës ushtron të drejtat e aksionarit për KEK SH.A., dhe Ujmanin, dhe duke vlerësuar gjendjen financiare të ndërmarrjeve, me Vendim, mund të kërkoj deklarimin e dividendës nga Bordet e Drejtorëve të këtyre dy ndërmarrjeve. Pagesa e dividendës bëhet në Buxhetin e Kosovës (Buxheti I shtetit).

Në rastin e KOSTT SH.A., Kuvendi i Kosovës është trupi (institucioni) i vetëm që, me Vendim, dhe përmes përfaqësuesit të tij (aksionarit), mund të kërkoj deklarimin e dividendës. Si rrjedhojë Bordi i Drejtorëve do vlerësoj kërkesën dhe deklaroj dividendën, dhe bëjë pagesën në Buxhetin e Kosovës.

Mënyra e përcaktimit dhe shfrytëzimit të Buxhetit të Kosovës është e rregulluar me Ligjin për Buxhetin, të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.

- ***Të elaboroj më mirë kompetencat e Qeverisë, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik në raport me KOSTT SH.A., dhe ti përfshijë në Vendimin Final, në mënyrë që eliminoj ndonjë konflikt eventual të interesit lidhur me informatat konfidenciale që KOSTT SH.A., mund ti ndaj me ndonjë entitet/institucion publik.***

Ligji për Energjinë Elektrike, në Nenin 13/7 përcakton: “Me qëllim të monitorimit të zbatimit të politikave të sektorit të energjisë, Qeveria duhet **të mbahet e informuar nga Bordi i drejtorëve.**” Sipas kësaj është në diskrecionin e Bordit të Drejtorëve të KOSTT SH.A., të vlerësoj se a është dhe sa është ajo informatë relevante për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik që të vendos lidhur me zhvillimin e politikave sektoriale.

- ***Nëse Qeveria ka fjalën vendimtare në projektet infrastrukturore të KOSTT SH.A.***

²² Ligji për Shoqëritë Tregtare Nr. 06/L-016 (Gazeta Zyrtare Nr. 9/24 maj 2018, Prishtinë)

Çdo Huamarrje/kredi nga KOSTT SH.A., në relacion me Qeverinë si huamarrës kryesorë apo garantues që merr pjesë në marrëveshjet për Huan të lidhur nga KOSTT SH.A., për projektet infrastrukturore, **duhet paraprakisht të aprovohet nga ZRRE në përputhje me Planin Zhvillimor të Rrjetit të Transmetimit**. Pra në rast se KOSTT SH.A., i drejtohet ndonjë Institucioni Financiar Ndërkombëtar për financimin e ndonjë projekti ku Qeveria/Shteti është garantues, ai projekt duhet paraprakisht të jetë i vlerësuar dhe aprovuar nga ZRRE si dhe përfshirë në Planin Zhvillimor të Rrjetit të Transmetimit dhe që të lejohet kthimi i investimit përmes procesit tarifor. Pas aprovimit të projektit të tillë KOSTT SH.A., i drejtohet Qeverisë që të inicioj lidhjen e Marrëveshjes Financiare e cila pastaj duhet **ratifikuar nga Kuvendi I Republikës së Kosovës si Marrëveshje Financiare Ndërkombëtare**.

Huamarrjet/kreditë nga KOSTT SH.A., nuk kushtëzohet vetëm sipas asaj që u tha më lartë, sepse për shembull me rastin e lidhjes së Marrëveshjes së Huas në vlerë 30 milion euro mes KOSTT dhe BERZH, nuk ka pasur nevojë për garanci shtetërore.

- ***Të hetoj raste konkrete dhe ti vlerësoje ndikimin e Ministrisë së Financave, e cila kontrollon aktivitetin e gjenerimit, nëse ka aprovuar apo refuzuar ndonjë vendim të KOSTT SH.A., apo të Kuvendit të Kosovës (si aksionar) lidhur me ndonjë ngjarje të rëndësishme. Nëse ZRRE e vlerëson të domosdoshme, ta kushtëzojë Certifikimin e KOSTT me ndryshime të kornizës ligjore.***

Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Ligji Nr. 03/L-048²³) në Nenin 56 i referohet Ndërmarrjeve Publike Autonome, definicioni i të cilave është i dhënë më poshtë. KOSTT SH.A., është Ndërmarrjeve Publike Autonome, dhe ka për obligim vetëm ta **njoftoj** Ministrinë e Financave lidhur me synimin për të kërkuar hua/fonde, por **jo aprovimin** e saj.

“Ndërmarrje Autonome Publike”- do të thotë (i) të gjitha njësitë e përcaktuara, dhe (ii) të gjitha ndërmarrjet tjera publike që ushtrojë veprimtarinë e tyre me autonomi substanciale. Për qëllime të këtij neni “autonomi substanciale” konsiderohet kur ndërmarrja nuk i nënshtrohet menaxhimit të drejtpërdrejtë nga një autoritet publik; sidoqoftë, nëse menaxhmenti i ndërmarrjes publike është vetëm nën mbikëqyrje të autoritetit publik, atëherë kjo mbikëqyrje nuk konsiderohet si menaxhim i drejtpërdrejtë i ndërmarrjes publike nga autoriteti publik.

Gjithashtu Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë në Nenin 56 nuk përcakton se për ndonjë ngjarje të rëndësishme duhet aprovimi nga Ministria, por përcakton vetëm që KOSTT SH.A., ta njoftoj Ministrinë. Kjo mund të dëshmohej në rastin konkret kur KOSTT vetëm ka njoftuar Ministrinë lidhur me huan/kreditë e mare nga BERZH. Keqkuptimi i SKE lidhur me këtë mund të ketë lindur si rezultat i përkthimit të aplikacionit për certifikim ose Vendimit Preliminar për Certifikim.

Neni 56 “Njoftimi mbi Ngjarjet e Rëndësishme”

Nëse një ndërmarrje autonome publike propozon të ndërmarrë cilindo nga veprimet në vijim, ndërmarrja autonome publike duhet që së pari t’i sigurojnë Ministrin një raport me shkrim i cili përmban informata të hollësishme mbi veprimin e propozuar:

²³ Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048 (Gazeta Zyrtare Viti III. Nr. 27/03 qershor 2008, Prishtinë), Ndryshim –plotësimi i Ligjit me Ligjet Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194, Nr. 05/L-063 dhe Nr. 05/L-007 (Gazeta Zyrtare nr. 13/21 prill 2016, Prishinë).

- a) themelimin ose marrjen pjesë në themelimin e një personi juridik, kompanie, ortakërie, trusti, sipërmarrje të përbashkët afariste pa personalitet juridik, ose çfarëdo shoqërie tregtare ose jo tregtare ose shoqate;
- b) të kërkojë, ekspozojë apo të modifikoj karakterin apo përmasat e shtrirjes së çfarëdo interesi të mbajtur nga një organizatë apo shoqatë e përmendur në pikën (a);
- c) përvetësimin apo rregullimin e çfarëdo pasurie operative apo të rëndësishme;
- d) shuarjen, zgjerimin apo modifikimin e veprimtarive;
- e) ushtrimin e interesave pronësore ndaj cilësdo prej organizatave apo shoqatave të përmendura në pikën (a), më lartë, për të nxitur një organizatë të tillë që të ndër marrë veprimet e saktësuar në pikat (a)-(d) më lartë; dhe
- f) angazhimin në çfarëdo aktiviteti huamarrës ose huadhënës.

- Të vlerësojë kompetencat e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të dhëna me nenin 30 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, e që ka të bëjë me të drejtën e vetos (aprovimit) të planeve zhvillimore të KOSTT SH.A. Nëse ZRRE e vlerëson të domosdoshme, ta kushtëzojë Certifikimin e KOSTT deri në eliminimin e një të drejte të tillë.

Neni 30 i Ligjit për Ndërmarrjet Publike nuk aplikohet kur ka të bëjë me Nenin 14/15 të Ligjit për Energjinë Elektrike, i cili përcakton: *“Dispozitat e Ligjit për Ndërmarrje Publike, lidhur me kompetencën për emërimin e Bordit të Drejtorëve, ushtrimin e të drejtave të aksionarit, kompensimin e Bordit të drejtorëve dhe raportimin, dhe emërimin e Komisionit të Auditimit, nuk vlejnë për Operatorin e Sistemit të Transmetimit.”*

KOSTT SH.A., tani më e ka njoftuar Ministrinë se pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Energjinë Elektrike, nuk ka obligim të raportoj, andaj do të ndërpres raportimin.

Planet Zhvillimore dhe Investive të KOSTT SH.A., aprovohen nga ZRRE, në përputhje me Ligjin për Energjinë Elektrike, Nenin 16/1/12²⁴ i cili përcakton: *“përpilimi brenda vitit që i paraprinë periudhës pesë (5) vjeçare, planin pesë (5) vjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit. Ky plan duhet të miratohet nga*

Rregullatori para se të publikohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe duhet të jetë i harmonizuar me Planin dhjetë (10) vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit, dokumentacionin e planifikimit hapësinor dhe të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes” ndërsa Nenin 16/1/13 përcakton: *“zhvillimi dhe publikimi, brenda vitit, që i paraprinë vitit të parë të Planit investiv, Planin investiv pesë (5) vjeçar, të miratuar paraprakisht nga Rregullatori të harmonizuar me Planin dhjetë (10) vjeçar dhe atë pesë (5) vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit dhe dokumentacionit të planifikimit hapësinor”.*

- Të vlerësojë dhe sqarojë raportet mes tri institucioneve/trupave publike (Qeverisë, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Ministrisë së Financave) të cekura në pikat më lartë, dhe kërkohet nga ZRRE që në Vendimin Final ta bëjë vlerësimin e pajtueshmërisë. Nëse ZRRE e vlerëson të domosdoshme, ta kushtëzojë Certifikimin e KOSTT SH.A., me bartjen e të gjitha përgjegjësiave nga ato institucione publike te Kuvendi i Kosovës, dhe nëse ky proces kërkon ndryshimin e legjislacionit, të jap afatet e arsyeshme kohore për ndryshime të tilla.

²⁴ Ligji për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085 (Gazeta Zyrtare nr. 26/ 21 korrik 2016, Prishtinë)

Nga arsyetimit e dhëna më lartë ZRRE nuk sheh ndonjë arsye për ta argumentuar më tutje këtë çështje. ZRRE mbetet e përkushtuar që gjatë periudhës së ardhshme t'i monitoroj këto raporte mes KOSTT/Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik/Ministrisë së Financave, dhe në rast të identifikimit eventual të ndonjë nga vërejtjet e SKE, të ndërmerr veprimet e duhura për eliminimin e tyre.

3. **Qeverisja (menaxhimi) e KOSTT SH.A., për të mundësuar pavarësinë e plotë për vendimmarrjen në baza ditore**, andaj Sekretariati fton ZRRE-në që:

- **Të vlerësojë edhe më tutje dhe ta përfshijë në Vendimin final pavarësinë e KOSTT SH.A., gjatë operimit në baza ditore dhe posaçërisht implementimin de facto të dispozitave ligjore që i referohen KOSTT SH.A., pasi që këto dispozita ligjore (rregulla) janë nxjerr para se të bëhej shthurja pronësore e KOSTT SH.A. ZRRE të verifikojë nëse këto dispozita ligjore (rregulla) janë në përputhje me kërkesat për shthurje pronësore**
- **Sekretariati fton ZRRE-në për të kërkuar nga KOSTT SH.A., që të zbatojë një program të pajtueshmërisë si dhe të emërojë një zyrtar të pajtueshmërisë.**

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Opinionin e tij, ka konsideruar si të dobishme që t'i kërkohet KOSTT/OST që të zbatojë një Program të Pajtueshmërisë dhe të emërojë një Zyrtar të Pajtueshmërisë.

Lidhur me kërkesën/rekomandimin e Sekretariatit, ashtu siç është përcaktuar në nenin 21 të Direktivës për Energjinë Elektrike dhe Nenin 21 të Rregullës për Certifikimin e OST, KOSTT SH.A., i certifikuar obligohet që të hartoj Programin e Pajtueshmërisë dhe emëroj Zyrtarin e Pajtueshmërisë si në pikën III. të dispozitivit të këtij Vendimi, dhe t'i dorëzojë për miratim në ZRRE.

Në përfundim Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka mbështetur Certifikimin e KOSTT SH.A., në përputhje me Vendimin Preliminar V_1033_2018 të datës 24 tetor 2018, duke iu nënshtruar vërejtjeve të cilat janë adresuar më lartë me këtë vendim.

Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të dëshmimeve që ndërlidhen me Certifikimin e KOSTT dhe Opinionin e SKE, konsideron se janë përmbushur të gjitha obligimet që rrjedhin nga Direktiva 2009/72/EC dhe Ligjet e Kosovës, dhe bazuar në këto, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.


- IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe s'bashku me Opinionin e SKE-së, do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë ligjore: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Bashkëngjitur këtij Vendimi:

Opinioni SKE Nr. 2/19 i nxjerrë në përputhje me Nenin 3(1) të Rregullores (EC)Nr.714/2009 dhe Nenit 10 (6) të Direktivës 2009/72/EC-Certifikimi i KOSTT.

Bordi i ZRRE-së:




Arsim Janova, u.d. Kryesues



Besim Sejfi, anëtar



Selman Hoti, anëtar



Izet Rushiti, anëtar

Vendimi i dërgohet:

- KOSTT SH.A.,
- Përfaqësuesit të Autorizuar të Kuvendit të Kosovës,
- Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, Vjenë, dhe
- Arkivës së ZRRE-së